

FSHDPA dhe shoqatat e grupit të avokatisë kanë realizuar sfidën e këtij viti

Vit i arritjeve të mëdha

U arrit hartimi i Strategjise Kombetare te Aftesise se Kufizuar, i cili u lançua më datën 3 dhjetor 2003

U percaktuan prioritetet: brenda fushave qe realizojne gjithë perfshirje ne perputhje dhe me prioritetet dhe standartet e BE. Po më 3 Dhjetor, Keshilli i Rregullimit te Teritorit te Republikes se Shqiperise miratoi Paketën e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike per PAK



Konkluzione

Zgjedhjet vendore 2003 në Shqipëri

Një vështrim mbi zgjedhësit që nuk mund të lëvizin nga shtëpia, të shtruarit në spital dhe me aftësi të kufizuara

FAQE 5

Votimet

Ne vëzhgues dhe votues, si gjithë të tjerët

Disa nga personat me aftësi të kufizuara tregojnë ditën e votimit, emocionet që kanë ndjere kur kanë hedhur votën e tyre të parë e kur e kanë ndjere veten të barabartë me gjithë të tjerët.

FAQE 9

Projekti

Shpresa...vjen prej Hollandës

Një projekt hollandez do të mundesoje ndertimin e një godine të re për prodhimin e karrigeve me rrota. Fondet po mbledhen nga punonjësit e kompanisë Nuon, nga puna dhe pagesa që ata marrin në ditën e pushimit.

FAQE 12

Arritja e 3 dhjetorit: HARTIMI I DRAFTIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE



Revistë e
përtremuajshme

Financuar nga:
Komiteti Suedez i
Helsinki për të
Drejtat e Njeriut

Fondacioni
Shqiptar
për të Drejtat
e Personave
me Aftësi
të Kufizuar

Bashkëpunëtorë:

Jerry Mindes

Maaïke de Boer

Maaïke Beerepoot

Bardhylka Kospiri

Zela Koka

Ilir Cane

Adresa:
Rruga
"Mujo Ulqinaku"
Nr.26 Tiranë

Tel.Fax:
++355 4 266892

E-mail:
adrf@icc.al.eu.org
www.adrf.org.al

Në datë 3 Dhjetor 2003, ne Diten Nderkombetare te Aftesise se Kufizuar, qe njekohesisht ishte edhe dita e mbylljes se Vitit Nderkombetar dhe European te Aftesise se Kufizuar, ne ambientet e Hotel Sheraton ne Tirane zhvilloi punimet Konferenca Kombetare per lancimin e draftit te Strategjise se Aftesise se Kufizuar. Pergatitja e nje ketij drafti, nga nje Grup Pune Nderministror, i ngritur me vendim te Keshillit te Ministrave, i drejtuar nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, ishte faza e dyte e procesit te hartimit te kesaj strategjie

Faza e pare e hartimit te strategjise konkludoi me pergatitjen e nje studimi te bere nga shoqatat e pothuajse te gjithë spektrit te aftesise se kufizuar, anetare te Grupimit te Shoqatave prane FSHDDPAK, qe analizoi gjendjen reale ne Shqiperi, nen kendveshtrimin e Rregullave Standarte te OKB mbi Barazine e Mundesive per PAK. Realizimi i kesaj konference ishte rezultat i bashkepunimit te Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale dhe Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar me OSBE e cila ofroi bashkepunim dhe mundesoi financiarisht realizimin e kesaj konference. Ne konference moren pjese te gjitha shoqatat qe moren pjese ne pergatitjen e studimit, organizata te tjera te fushes se AK, perfaqesues te institucioneve, anetare te grupit nderministror, perfaqesues te trupit diplomatik ne Shqiperi, perfaqesues te OSBE, IFES, ODIHR, EDF, etj.

Organizimi i kesaj konference dhe rekomandimet e dala nga diskutimet e pjesemarrësve, shenuan realizimin e sfides me te rendesishme te Grupimit te Shoqatave prane FSHDDPAK per vitin Nderkombetar te AK- Hartimi i Draftit te Strategjise se Aftesise se Kufizuar.

Një vit i suksesshëm

3 Dhjetor 2003, dita e mbylljes se Vitit Nderkombetar e European te Aftesise se Kufizuar, shenoi sfiden me te madhe te ketij viti, per Fondacionin Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar dhe shoqatat anetare te grupit te avokatise: **Hartimin e Strate-gjise Kombetare te Aftesise se Kufizuar.**

Duke e kosideruar Vitin 2003, si Viti qe arriti ta vendosi AK, ne prioritet te axhendes politike e sociale , ne Shqiperi , le t'i kthehemi dhe njehere thenies se ky vit do te quhet vertet i suksesshmen nese ai do te shenoje arritje qe synojne pertej vitit 2003.

Draft - Strategjia qe u lancua ne 3 Dhjetor 2003, hedh vetem themelet e nje procesi dhe nje dinamike ne vazhdimesi e cila do te krijojte perfshirje te plote te njerezve me AK ne shoqeri ndersa synojme ndertimin e nje shteti social qe krijon me te vertete shanse te barabarta. Grupi nderministror me perfshirjen e Ministrive dhe Institucioneve Shtetore ne zbatim te vendimit te Qeverise dhe nen drejtimin dhe perkushtimin total te MPCS, me mbeshetjen dhe perfshirjen ne vazhdimesi te Grupit te avokatise prane FSHDPAK me perfaqesim te gjithe Shoqatave te spektrit te AK, ku do te veconim si ato me shtr-

irje e perfaqesim te gjere si Shoqata Kombetare ne Ndi-hme te Handikapeve Mendore, Shoqata e Invalideve te Punes se Shqiperise, Shoqata e Paraplegjikeve dhe Tetraplegjikeve, Shoqata e Njerezve qe nuk degjojne , Shoqata e te Verberve te Shqiperise, Shoqata Shqiptare e Grave me AK, si dhe shoqata lokale aktive MEDPAK , Ndi-hmoni Jeten, Shoqata e Krijuesve te Rinj te talentuar, e indvide aktive e eksperte te fushes si Prof. Virxhil Nano etj, do te vazhdoje punen per finalizimin e draftit te strategjise dhe ka arritur tashme dhe ne **percaktimin e prioriteteteve**, ku do te veconim:

■ **Legjislacion mosdiskriminues**

■ **Mekanizmat e nevojshem implementues dhe monitories**

■ **Si dhe prioritetet brenda fushave qe realizojne gjitheperfshirje ne perputhje dhe me prioritetet dhe standartet e BE ku mund te permenden:**

■ Krijimin e nje ambjenti te pershtatur permes eliminimit te barrierave ne qendrim, barrierave institucionale dhe ne mjedis

■ Nxitja e gjitheperfshirjes permes punesimit

■ Nxitja e integritimit social duke shmanguar dhe luftuar perjashtimin

■ Fuqizimi dhe ngritja ne

nje shkalle me te larte e strukturave te nevojshme ne shoqeri qe realizojne ne menyre te qendrushme pjesemarrjen, futja (mainstream) e prespektives se AK ne sektoret perkates te politikave .

Ky process, vec partnereve lokale, ka tashme mbeshetjen dhe ekspertizen e ofruar nga OSBE si dhe sigurine per mbeshetje nga forume dhe partnere te tjere nderkombetare.

FSHDPAK, nje vit me pare, ne 2 Dhjetor 2002, ne nje Konferenc per shtyp, ne prani te gjithe partnereve , vec Sfides kryesore, ate te Hartimit te Strategjise lancoi dhe Sfida te tjera ne kuadrin e Vitit European .

1-Hartimi dhe miratimi nga KRRTRSH i Paketes se Normave Urbanistike dhe Arkitektonike te aftesise se kufizuar ne 3 Dhjetor 2003.

2-Permiresim, por jo i plote i Kodit Elektoral, duke krijuar mundesi reale per perfshirjen e PAK ne procesin Elektoral. Pjesemarrja si vzhgues e nje grupi PAK ne zgjedhjet per pushtetin vendor , Tetor 2003, sherbeu per te hartuar rekomandimet dhe strategji te nderhyrjes, qe do te mundesojne realisht respektimin e te drejtes civile dhe politike te qytetareve zgjedhes me AK. Nje dialog i hapur me politikberesit, por

Ne date 3 Dhjetor 2003 Keshilli i Rregullimit te Teritorit te Republikes se Shqiperise miratoi Paketën e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike per PAK

MIRATOHET PAKETA E NORMAVE URBANISTIKE DHE ARKITEKTONIKE PER AFTESINE E KUFIZUAR

Kjo pakete eshte e para e ketij lloji qe do t'i bashkangjitet Normave Shqiptare te Urbanistikes duke plotesuar keshtu boshllekun e mbartur prej vitesh persa i perket elementeve te pershtatshmerise ne normat e ndertimit

Procesi i hartimit te kesaj Pakete Normash eshte zhvilluar ne nje periudhe kohore tre vjecare si nisme e Grupit te Avokatise prane Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Afatesi te Kufizuar (FSHDDPAK, si nje levizje e organizuar per te ndertuar nje mjedis pa barriera qe mundeson integrimin e personave me afatesi te kufizuar ne jeten shoqerore.

Procesi filloi me perpjekjet ndergjegjesuese te Grupit te Avokatise per te sensibilizuar opinionin publik, rrjetin e institucioneve, kryesisht te

fushes se ndertimit, per rendesine dhe domosdoshmerine e percaktimit te normave dhe standarteve shqiptare per afatesine e kufizuar, kjo e diktuar nga mungesa totale e pershtatshmerise ne mjedisin ndertimor ne Shqiperi qe pengon integrimin e PAK ne jeten shoqerore. Gjithashtu procesi i asociimit te Shqiperise ne Bashkimin Europian kerkon percaktimin e standarteve qe t'i pergjigjen nivelit bashkekohor europian.

Kjo pakete permban norma urbanistike dhe arkitektonike, te hartuara duke u bazuar ne eksperiencen shqiptare ne fushen e ndertimit si edhe ne eksperiencat dhe standartet nderkombetare.

Per hartimin e kesaj pakete FSHDDPAK ka patur mbeshtetjen e vazhdueshme te Ministrise se Rregullimit te Teritorit dhe Turizmit, si dhe ka bashkepunuar ngushtesisht me Institutin e Studimeve Urbanistike, Shoqaten e Nderguesve te Shqiperise dhe Shoqaten e Arkitekteve te Shqiperise.

vijon nga faqja 3

dhe me organet egzekutive , ku do te veconim KQZ, do te sherbeje per realizimin e praktikave mosdiskriminuese dhe modeleve te gjithepershirjes se PAK- ve ne proceset elektorale

Nje faktor shume i rendesishem per arritjet e ketij viti ishte, **fuqizimi dhe efikasiteti i partneriteteve**, Qeveri-Institucione shtetere- Shoqeri civile, organizatat e AK , donatore dhe organizma lokale e nderkombetare te interesuar per te kontribuar ne permiresimin e cilesise se jetes per njerezit me AK. Nder objektivat kryesore te Vitit 2003, si viti Europian i AK ishte pershpajtimi i kthimit te kendveshtrimit, persa i perket menyres se si shoqeria i konsideron njerezit me AK . **MEDIA** luan nje rol te rendesishem ne kete drejtim, ndaj ka qene dhe nder aleatet kryesore te FSHDDPAK gjate ketij viti.

Jemi te ndergjegjshem se progresi ka qene kryesisht, por jo vetem, ne nivel politik. Por jemi te bindur se progresi ne nivelin politik do te rrise shpejtesine e ndryshimeve drejt nje shoqerie qe respekton plotesisht te drejtat e te gjithë personave me afatesi te kufizuar.

FSHDDPAK ne perputhje me Vizionin “ Per nje shoqeri per te gjithë” dhe misionin e vet “Promovim I shanseve te barabarta dhe mbrojtja e vazhdueshme e te drejtave te PAK me synim permiresimin e cilesise se jetes per ta dhe familjet e tyre” do te vazhdoje te jete model integrimi dhe permes aktivitetit te vet te kontriboje ne perfshirjen e plote te PAK dhe respektimin e te drejtave te tyre njerezore.

Zgjedhjet vendore 2003 në Shqipëri



Nga Jerry MINDES

Për arsye të ndryshimeve në kodin zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë nuk e ndjek më praktikën e përdorimit të kutive të lëvizshme të votimit, e cila është një praktikë standarte zgjedhore në shumë vende, ku zyrtarët zgjedhorë vizitojnë shtëpitë e zgjedhësve në ditën e votimit, duke i'u ofruar në këtë mënyrë mundësinë, zgjedhësve të moshuar, apo me aftësi të kufizuara fizike për të votuar. Kjo praktikë u ndërpre disa vjet më parë për arsye të shqetësimeve në lidhje me manipulimin. Megjithatë, nuk u përdor asnjë mekanizëm tjetër për t'i ndihmuar qytetarët që e kanë të pamundur të largohen nga shtëpitë e tyre për të votuar.

Qysh prej vitit 2002, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF) është përfshirë në përpjekjet për të bërë të mundur që Kuvendi të trajtojë të drejtat e zgjedhësve të cilët e kanë të pamundur të lëvizin nga shtëpitë e tyre, dhe për të

Një vështrim mbi
zgjedhësit
që nuk mund
të lëvizin nga sh-
tëpia, të shtruarit
në spital dhe me
aftësi të kufizuara

mbrojtur të drejtat e zgjedhësve me të gjitha llojet e kufizimit të aftësive fizike, mendore, apo të ndjeshmërisë.

Më 13 tetor 2003, një ditë pas zgjedhjeve vendore, ADRF-ja zhvilloi një vëzhgim studimor me nxënësit e pesë shkollave të mesme në kryeqytet, Tiranë. Nxënësit e klasës së tetë – që përfaqësojnë 647 familje – u pyetën nëse ndonjë prej anëtarëve të familjeve të tyre e kishte të pamundur që të votonte në ditën e mëparshme të zgjedhjeve për arsye të ndonjë problemi të lëvizjes, apo për arsye të moshës së kaluar, verbërsisë, apo ndonjë kufizimi afatshkurtër ose afatgjatë të aftësive fizike.

Një total prej 11.3 për qind e adoleshentëve raportuan se të paktën një person në shtëpitë e tyre nuk kishte mundur të votonte për arsye të një kufizimi fizik afatshkurtër apo afatgjatë.

Kjo do të thotë se një në çdo nëntë shtëpi, në pesë prej lagjeve të Tiranës, të paktën një individ – një gjysh, një prind, një vëlla, apo një motër – e kishte të pamundur të votonte, për arsye të një vendimi të ligjvënësve për t'a ndërprerë përdorimin e kutive të lëvizshme të votimit.

Rezultatet e vëzhgimit studimor treguan se të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara afatshkurtër përbënin segmentet më të mëdhaja të atyre që nuk mundën të votojnë.

Kjo është përpjekja e parë e njohur, në çdo vend, për të bërë të mundur përcaktimin e numrit të zgjedhësve të cilët kanë nevojë për të votuar në shtëpi. Kjo përpjekje është e rëndësishme, sepse përdorimi i kutive të lëvizshme të votimit është kritikuar shpesh si hapje
vijon në faqen 6

vijon nga faqja 5

e rrugës për manipulim. Në të paktën dy vende – Shqipëri dhe Armeni – këto shqetësime kanë çuar në ndryshime në ligjin zgjedhor për të parandaluar përdorimin e kutive të lëvizshme të votimit, duke i lënë të pashpresë ata që janë fizikisht të pamundur për të shkuar vetë në qendrat publike të votimit. Gjithashtu, edhe organizata ndërkombëtare, të cilat vendosin standartet për zgjedhje të lira dhe të ndershme, e kanë përdorur arsyetimin e “manipulimit” për të dekurajuar votimin në shtëpi.

Nëpërmjet vëzhgimit studimor pilot në Shqipëri, ADRF-ja dhe Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet e Zgjedhjeve në Shqipëri (IFES) po punojnë për të rihapur dialogun me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me partitë politike dhe Anëtarët e Parlamentit, mbi të drejtën e të gjithë zgjedhësve – edhe të atyre që nuk mund të lëvizin nga shtëpitë – për të votuar. ADRF-ja dhe IFES-i po propozojnë zhvillimin e një kërkimi studimor të mëtejshëm për t’i mëshuar faktit se të drejtat zgjedhore të qytetarëve që e kanë të pamundur të lëvizin nga shtëpitë e tyre janë duke u anashkaluar.

Një mënyrë tjetër për të monitoruar zgjedhjet

Nëpërmjet përpjekjeve të veta këtë vjeshtë, grupi shqiptar i mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ka demonstruar se monitorimi i

zgjedhjeve nuk ka të bëjë vetëm me vëzhgimin e atyre që marrin pjesë në ditën e zgjedhjeve: zgjedhësve, kandidatëve, partive politike, zyrtarëve zgjedhorë, dhe medias. Ndonjëherë, monitorimi i zgjedhjeve ka të bëjë edhe me vëzhgimin e atyre që nuk mund të votojnë dhe përpiqen të zbulojnë se përse ndodh kjo gjë.

Refuzimi i të drejtave zgjedhore të zgjedhësve që nuk mund të lëvizin nga shtëpia është vetëm një prej objektivave të punës së ADRF-së. Nëpërmjet edukimit qytetar, dhe monitorimit të zgjedhjeve prej qytetarëve me aftësi të kufizuara, ADRF-ja hedh gjithashtu vështrimin mbi nevojën e përmirësimit të legjislacionit ekzistues shqiptar për zgjedhjet me raportimin për përshtatshmërinë e qendrave të votimit, të drejtën e qytetarëve të verbër për të votuar në fshehtësi, dhe të drejtat e qytetarëve të cilët janë të hospitalizuar, gjë e cila i pengon plotësisht për të marrë pjesë në procesin zgjedhor.

Përpjekja për monitorimin e zgjedhjeve nga ADRF-ja dhe IFES-i, gjithashtu pëfshiu edhe administrimin e dispozitave të ligjit zgjedhor që ju ofron mundësinë të burgo-surve për të votuar.

Edukimi qytetar. “Edhe vota ime sjell ndryshimin” Përpara zgjedhjeve, grupi shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ka punuar për edukimin e publikut të gjerë

mbi të drejtat e zgjedhësve me aftësi të kufizuara, dhe mbi vështrësitë që ata hasin në ushtrimin e të drejtave të tyre. Pjesë e këtij edukimi qytetar është edhe posteri (shih në të majtë) i shpërndarë nga ADRF-ja nëpër qindra vendodhje të qyteteve të Tiranës, Elbasanit, and Librazhdit. Slogani i posterit thotë “Edhe vota ime sjell ndryshimin”.

ADRF-ja ka qenë gjithashtu e suksesshme në botimin e një gazete, dhe pasqyrimin në radio dhe televizion të përpjekjeve të saj të monitorimit të zgjedhjeve përgjatë javëve përpara zgjedhjeve, duke përfshirë:

- Një kronikë lajmesh të prodhuar nga Zëri i Amerikës, të transmetuar në televizionin shqiptar përgjatë javëve përpara zgjedhjeve, me përfaqësuesit e ADRF-së dhe IFES-it;

- Një program të veçantë televiziv në Elbasan në lidhje me çështjet e personave me aftësi të kufizuara;

- Një kronikë speciale lajmesh në ditën e zgjedhjeve me zj. Drita Hajdari, një grua e re me aftësi të kufizuara, e cila shërbeu si vëzhguese e zgjedhjeve në Tiranë; dhe

- Një seri artikujsh në ditën e zgjedhjeve në gazetën e përditshme, Korrieri, me vëzhguesit e ADRF-së, duke përfshirë dy vëzhguesë me mungesë dëgjimi, si edhe një intervistë me një përfaqësues nga IFES-i.

Monitorimi i zgjedhjeve. Më 12 tetor 2003, në ditën e zgjedhjeve në Shqipëri, shatatëdhjetë e pesë (75) qyteta-

rë me aftësi të kufizuara shërbyen si Vëzhgues të plotë të akredituar dhe trajnuar të Zgjedhjeve. Ata punuan në qytetet e Tiranës, Elbasanit dhe Librazhdit, duke monitoruar nëse zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me ligjin shqiptar dhe standartet ndërkombëtare, duke i kushuar vëmendje të veçantë shkallës së përshtatshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara, dhe përvojës së zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

Vëzhguesit e zgjedhjeve u trajnuan nga përfaqësues të ADRF-së, të cilët punuan në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën për Kulturë Demokratike, e cila është organizata më e madhe vendore e monitorimit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Në konferencën për shtyp më 13 tetor në Hotel Sheraton Tirana, zj. Kospiri (në të djathtë) citoi tre fusha në të cilat nuk u zbatua kodi zgjedhor: pothuajse të gjitha qendrat e votimit ishin të papërshtatshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara; pati një mungesë komunikimi midis autoriteteve zgjedhore dhe spitalore që çoi në pamundësinë e pjesës më të madhe të pacientëve të shtruar në spital për të votuar; dhe votuesve të verbër nuk ju ofrua mundësia për të votuar në fshehtësi.

Votimi në spital: Ligji shqiptar për zgjedhjet i kërkon komisionit të zgjedhjeve që t'ju ofrojë qytetarëve të hospitalizuar një mundësi për të

votuar. Fatkeqësisht, procedurat e ndjekura nuk ishin gjithmonë në përputhje me ligjin, duke çuar kështu në pamundësinë për të votuar të një përqindjeje të konsiderueshme të personave me të drejtë vote. Në Spitalin Nënë Tereza në Tiranë, për shembull, administratorët e spitalit i ofruan komisionit vendor zgjedhor një listë me rreth 200 persona me të drejtë vote, të cilët ishin të hospitalizuar. Lista u refuzua nga komisioni vendor zgjedhor sepse ishte e shkruar me shkrim dore dhe nuk ofronte informacionin e mjaftueshëm për të identifikuar zgjedhësit. Autoritetet spitalore dhe ato zgjedhorë fajësuan njëri-tjetrin për lapsusin e dukshëm në komunikim.

Votimi në burg: Zgjedhjet në Burgun Numër 313, një institucion i sigurisë së lartë, rreth një rrugë larg stacionit kryesor të trenit në Tiranë, u zhvilluan në mënyrë të rregullt dhe pa animozitetin e përfaqësuesve të partive politike, gjë që karakterizoi shumë prej qendrave të tjera të votimit. U regjistruan për të votuar një total prej 230 të burgosurish, dhe vetëm 13 prej tyre nuk u paraqitën për të votuar në ditën e zgjedhjeve. Të burgosurit u sollën në zonën e votimit në grupe prej 10 dhe 15 vetash. Ata u shoqëruan në një dhomë pritjeje, muret e së cilës ishin pajisur me postera të edukimit të zgjedhësve. Tre deri në katër prej këtyre të burgosurve silleshin në një dhomë të dytë pranë hollit, e

cila ishte përgatitur për procesin e votimit. Aty, një komision i plotë zgjedhor prej shtatë vetash zbatonte procedurat me zgjedhësit, duke kontrolluar identifikimin e tyre, duke llyer gishtin me bojën e padukshme, dhe duke i'u ofruar fletët e votimit zgjedhësve me të cilat të burgosurit shkonin në dhomat e votimit: pra, të gjitha procedurat standarte.

Hapat e mëtejshëm. Gjatë javëve të ardhshme, ADRF-ja do të kërkojë bashkëpunimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të diskutuar mënyrën e përmirësimit të administrimit të ligjit ekzistues zgjedhor, dhe për të identifikuar fushat, të cilat mund të kërkojnë reformë të mëtejshme të ligjit zgjedhor. Ligji ekzistues zgjedhor, nëse zbatohet plotësisht, duhet të lejojë ndryshime të qenësishme në përzgjedhjen e qendrave të përshtatshme të votimit; duke ju ofruar votuesve të verbër të drejtën për të votuar në fshehtësi; dhe duke siguruar se pacientëve të spitalit ju ofrohet e drejta për të votuar. Legjislacioni ekzistues zgjedhor do të duhet të modifikohet nëse zgjedhësve që nuk kanë mundësi të lëvizin nga shtëpitë e tyre duhet t'ju ofrohet e drejta për të votuar. KQZ-ja, nën drejtimin e Ilirjan Celibashit, i'u është përgjigjur kërkesave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, dhe ka qenë i disponueshëm për të dëgjuar dhe vepruar për shqetësimet e këtij komuniteti.

Ne vijim te levizjes se organizuar te tyre per Te Drejten e Votes per Personat me Aftesi te Kufizuar, te Drejten per Akses Politik permes Perfshirjes ne Proceset Elektorale



Grupi i Vëzhguesve me Aftesi të Kufizuar në zgjedhjet vendore të 12 Tetorit 2003

Per here te pare ne historine e proceseve zgjedhore pas viteve '90, ne zgjedhjet vendore te 12 Tetorit 2003 u perfshine nje grup vezhguesish me aftesi te kufizuar. Perfshirja ne procesin e vezhgimit u inkuarua gjithashtu , si pjese e nje levizjeje me te gjere , ne kuadrin e forumit shqiptar te vezhguesve.

Monitorimi I procesit elektoral ne ditin e zgjedhjeve per pushtetin vendor te 12 Tetorit 2003 u fokusua ne dy aspekte kryesore, shume te rendesishme per procesin e demokratizimit te shoqerise shqiptare, ne pergjithesi dhe per problematiken e aftesise se kufizuar dhe integrimin e PAK - ve ne jeten shoqerore, ne veçanti :

I. Vezhgimin e procesit te votimit nepermjet vezhguesve me aftesi te kufizuar dhe familjareve te tyre, te akredituar si te tille nga KQZ.

II. Mbledhjen e informacionit per nivelin e pjesemarrjes se PAK ne procesin e votimit

Problematika e veçante ne te cilin u fokusua kishte te bente me faktin nese kishte ose jo persona me aftesi te kufizuar te rregjistruar ne listat zgjedhore ; nese ata e njihnin ligjin dhe nese kishin bere kerkese per rregjistrim; votuesit me aftesi te kufizuar votonin vete apo me ndihme; si ishte qendrimi i anetareve te komisionit ndaj votuesve me aftesi te kufizuar; a kishte akses qendra e votimit per PAK, a kishte elemente pershtatshmerie; per votuesit e verber a kishite flete te posaçme apo ata votonin me ndihmen e asistentit? Me perjas-

htime te rralla, qendrat e votimit ishin te papershtatshme (ne 90 % te rasteve) dhe nuk ofronin akses per personat me aftesi te kufizuar. Nuk ishin pergatitur flete votimi te posaçme per te verberit dhe ata votuan me shoqerues. I gjithë procesi ndikoi ne menyre pozitive tek vete personat me aftesi te kufizuar duke rritur vetvleresimin, gjithashtu edhe opinionin shoqeror pati nje impakt pozitiv

REKOMANDIME

Integrimi i personave me aftesi te kufizuar ne jeten shoqerore eshte nje aspekt shume i gjere, ai perfshin te gjitha fushat e jetes. Krijimi i mundesive per pjesemarrje sa me te gjere, ne menyre te barabarte e te drejtperdrejte te personave me aftesi te kufizuar ne proceset zgjedhore eshte hapi i pare, shume i rendesishem e i domosdoshem drejt integrimin te tyre te plote Nese shoqeria nuk i jep mundesine te gjithë qytetareve te marrin pjese ne menyre aktive dhe te barabarte ne jeten e saj ,te kerkojne e te mbrojne te drejtat e tyre edhe nepermjet mekanizmit te votes, ajo asnjehere nuk do te arrije nivelet e duhura te demokratizimit.

Te gjithë duhet te pranojme se realizimi i ketij objektivi perben nje sfide te vertete per te gjithë hartuesit e politikave, zbatuesit e tyre si dhe per te gjithë shoqerine.

Per te ecur me tej ne kete proces eshte e nevojshme :

- **Permiresimi i metejshem i kodit zgjedhor** duke synuar ne :
- Aplikimin e **votimit levizes** si

menyra me e mire per realizimin e pjesemarrjes sa me te gjere ne proceset e votimit .

● Nxjertja e udhezimeve ne mbeshtetje te kodit zgjedhor per realizimin e pershtatshmerise se qendrave dhe mjeteve te votimit.

● **Evidentimi dhe plotesimi i listave zgjedhore** me emrat e personave me aftesi te kufizuar (te bashkepunohet me OJQ te fushes dhe me pushtetin vendor), specifikimi sipas llojit te aftesise se kufizuar duke percaktuar edhe shperndarjen gjeografike te tyre .

● **Pergatitja e fleteve te votimit te posaçme per te verberit.**

● Percaktimi ne kohen e duhur i udhezimeve per **qendrat e posaçme te votimit** dhe ngritja e tyre konform ligjit.

● **Ndergjegjesimi i komisionereve** te KZZ, KZQV, KQV per problematiken e aftesise se kufizuar.

● **Ndergjegjesimi i hartuesve te politikave dhe kandidateve** per t'u zgjedhur ne te gjitha proceset zgjedhore, duke i perballur me faktin se kur edhe nje vote e vetme ndikon ne rezultatet perfundimtare, nuk mund te neglizhohen **17.59 % e votave.**

● **Bashkepunimi me MEDIA** -n per te fuqizuar rolin e saj ne ndergjegjesimin e opinionit shoqeror.

● **Ndergjegjesimi i te gjithë shoqerise** se ajo mund te shkoje drejt progresit vetem nese te gjithë anetareve te saj u respektohet dhe mundesohet barazisht e drejta e votes.

Ne vëzhgues dhe votues, si gjithë të tjerët

Disa nga personat me aftësi të kufizuar tregojnë ditën e votimit, emocionet që kanë ndjere kur kanë hedhur votën e tyre të pare e kur e kanë ndjere veten të barabartë me gjithë të tjerët.

Rrefimi i Florianit

Nje buzeqeshje e lehte i varet nder buze kur nis e tregon per ditën e votimit, per heren e para kur ndjeu se edhe ai si jithe te tjeret ka te drejten e votes se lire. Fytyra i çelet kur kujton gjithë punën që ka bere ne ate dite votimesh, si nje vëzhgues i zgjedhjeve ne zonen elektorale Nr. 1800. Me gjuhen e tij te shenjave Floriani rrefen permes interpretueses se tij, se te gjithë njerezit qe votonin cuditeshin me vëzhguesit e rinj, qe me teper arrinin te interpretonin me shenja se sa te flisnin me komisionin.

“Kjo me merziste paksa, - thote Floriani me ane te duarve te tij, por dhe me mimiken e fytyres. Ne oret e gjata te vëzh-

gimit, Floriani ka menduar gjate per moshataret e tij qe kane te njejtat probleme me te, edhe per ata qe nuk shikojne, te cilet nuk kane votuar as kete vit. “Do deshiroja shume qe te gjithë personat me aftësi te kufizuar te kishin pasur fatin tim ne keto zgjedhje, pra te mund te votonin e te mund te ndjenin ate qe ndjeva dhe une, barazine me te tjeret.

Me emocionet e Brunildes

Sapo ka mbushur 20 vjeç. Por vetem kete vit ka mundur te votoje, pasi aftësite e kufizuara te degjimit dhe te te folures qe ajo ka, e kane penguar ne gjithëheret. Ndersa ne 12 tetor, fati qe i mbare per te. “Votova per here te pare dhe isha vëzhguese ne Zonen nr.1755”-tregon ajo me gjuhen e gishtave, duke e shprehur ne sy kenaqesine e madhe qe i ka sjelle ajo dite e madhe per te.

Eltoni, voton me karrigen e tij

Elton Lleshi, nje i ri nga Laci, i cili ka vite qe qendron ne karrigen e tij nuk e ka per here te pare votën. “ Kam vite qe kam marre pjese ne votime “,- thote ai- Kete vit ka qene karrigia ime

ajo qe me ka cuar deri ne katet e larta te qendres se votimit ne Lac, ndersa vitet e tjera me kane ngjitur shoket e mi ose vellai” – thote ai duke shtuar me pas se ka pare ne kete vit votimi shume persona me aftësi te kufizuar qe kane shkuar vete ne qendrat e votimit, pasi u ishin krijuar te gjitha mundësite per t’u ngjitur ne katet e larta. “ Vertet po e ndjejme veten te barabartë me gjithë njerezit e tjere”, - pohon ai- Kjo eshte menyra me e mire per t’u integruar te gjithë njelloj ne jeten shoqerore.”

Bazuar mbi gjithë punën e bere, dhe me se shumti mbi rrefimin e ketyre personave mund te thuhet me ze te larte se keta vëzhgues me aftësi te kufizuar kane qene njelloj si gjithë të tjerët dhe kane pare me nga afer sesa te ndershme, te lira dhe transparente kane qene zgjedhjet ne vendin tone. Pas kesaj eksperience te pare, sic theksojne perfaqesuesit e Fondacionit per te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar, puna do te permiresohet edhe me shume, duke u menduar per te tjera eksperimentat edhe me frytdhenese.

Vjeshta

**Me madheshtore, stine bujare
vjeshta, vjeshta
per ne qe e deshem – miresi**

**Me kryenece dhe xheloze
vjeshta, vjeshta
per tinzare e te vobekte**

**Jetesore vjeshta e bukur
E me te emblave fruta
Vjeshta, vjeshta...**

**Vjeshta me unaza ne duar
stine e mrekulluar.**

**Vjeshta e kokrrave te pjekura
me e mira prej motrave vjeshta.**

ILIR CANE

Dita e votimit, 12 tetorit ne Librazhd. Ne qytetin ku krahas listave te votimit jane ngjitur dhe posterat “Edhe vota ime sjell ndryshim”, ideuar nga Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara. Ne qytetin ku PAK, kane qene jo vetem votues por edhe vezhgues te zgjedhjeve



EDHE VOTA IME SJELL NDRYSHIM...



I ulur mbi karrocen e tij, ku prej kohesh ka nisur ta jetoje ndryshe jeten e tij, koreografi i mirenjohur, artisti i merituar ne qytetin e Librazhdit Sadi Halili, eshte shfaqur ne diten e votimeveve, krah miqve te tij. Si nje here e nje kohe kur fluturonte me kembet e tij, kur kercente e udhetonte neper qytete te ndryshme te Shqipërisë e jashte saj, kudo ku e ftonin per koncerte. Derisa semundja e kryqezoi ne karrigen me rrota, por pa mundur ta shkepuse nga jeta dhe miqte e tij. Bashke me ta, shkoi ne qendren e votimit ne te djelen e 12 tetorit. Ndjeu edhe nje here le-

htesimin e votes se lire, qe ai leshoi prej duarve te tij. Te cilen kishte shume kohe qe nuk e jepte. Ndersa me 12 tetor, Sadi Halili votoi edhe nje here, ne nje qender ku ngjitja e karrocës u lehtesua nga perdorimi i rampes se levizeshme. Ndersa ai ngjitej, shume qytetare shikonin. E shprehin ne sy kenaqesine- “Sa mire qe po e shikojme Sadiun perseri te votoje me ne”. Artisti i merituar nuk ishte i vetmi qe iu drejtua qendres se votimit me karrocen e tij. Ate mengjes te 12 Tetorit ne qendrat e votimit, shume prej personave me aftesi te kufizuar jo vetem kane dhene voten e tyre

por dhe jane angazhuar per te vezhguar votimet, krahas personave te caktuar ne komisione dhe vezhguesve nga subjektet zgjedhore. Ne tryezat e komisioneve u ulen edhe personat me AK, dikush duke patur nje paterice e dikush nje karroce, duke pasur mundesite qe te levizte lirisht ne ambientin ku do te votohej. Disa jane edhe prinder femijesh te cilet kerkojne nje mbeshtetje kur votojne. Disa dite me pare krahas listave te votimit qytetaret Librazhdas pane edhe posterat “Edhe vota ime ndryshon” ideuar nga FSHDP. Kjo beri qe ata te shikonin dhe te kuptonin qe ata femije qe sot shkojne ne shkollen “Genc Leka” dhe integrohen me te tjere, neseser do ta kene me te lehte per te votuar, per te shprehur mendimin e tyre per qeverisjen e tyre. Ishte kjo nje iniciative kjo e Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar. Per te vezhguar keto zgjedhje u mblodhen se bashku nga

Kujtimi i një së diele

E djele, 12 Tetor 2003. Mengjes. Pak perpara se te niseshe, ben pergatitjet e duhura; stilolapsi, blloku i shenimeve, formularet per t'u plotesuar, t-shirt dhe mbi te gjitha bexhi i identifikimit, "pasaporta" e hapjes se dyerve.

Ora 10.00. E gjen vehten duke ngjitur shkallet e panumerta te fakultetit per te arritur qendren e votimit. Takon mikun tend . E pershendet dhe te ngrohet zemra kur sheh se edhe ai mban nje bexh. Do te jete tere kohes me ty. " Ngrohet zemra " thashe? Eh, po ! Si ne cdo vend ke gjithmone ndrojtje. Jo vetem fakti qe eshte e para here qe ke nje rol si vezhgues, por sepse je person me aftesi te kufizuar . Mund te te vijne qindra mendime ne koke , mund te imagjinosh qindra fjale te nxjerra nga gojet apo mendjet e njerezve. Besomeni! Te panumerta jane fjalet dhe shikimet e tyre.

"Me falni, mund te hyj?" Ky eshte fjalekalimi dhe dera hapet vete. Me ndrojtje pershendet vezhguesit dhe personat e tjere ne salle. Nje pershendetje mjafton, te tjerat i ben bexhi. Me qetesi, edhe pse pakez te pamundur , ze vend te prezantohesh: " Jam Elgita Metani. Vij nga Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara", nxjerr materialet e pergatitura me kujdes ne mengjes dhe ia nis punes – vezhgues ne qendren e votimit. Te ka shkuar ndonjehere ne mendje? Jo asnjehere. E sheh vehten tek vezhgon e qete procesin e votimit , pa harruar te shenosh qofte edhe levizjen me te vogel. Sikur luan shah. Duhet vemendje , durim, shkathtesi te kapesh cdo levizje te kundershartit. Po ndrojtja c'u be? Ah, ajo ka kohe qe ka ikur . Tashme je pjese e anetareve te rendesishem te qendres.

Nje fakt duhet theksuar ; je ne qendren e votimit te lagjes tende. Pra, nje pjese te mire te votuesve , si dhe te pjestareve te komisionit jane te njohurit e tu. Te shohin me perzemersi. Madje ka prej tyre qe shqiptojne ate shprehjen tashme popullore " e kapi vehten motra". Cdo levizje e vezhgon , e shenon. Degjon me kujdes cdo pyetje qe bejne vezhgues nga qendra te tjera, " vizitore" mund t'i quajme. " Si po shkon votimi" " Cilen parti perfaqsoni" Te deshperon fakti , kur degjon qe persona me aftesi te kufizuar nuk kane mundur te votojne vetem, sepse nuk kane deklaruar me pare se kane nevojte per shoqerues. Kjo gje u privon atyre ne menyre automatike votimin. Por te lehteson dicka tjeter. Vezhgues nga Gjermania dhe Franca i terheq fakti qe nje person me aftesi te kufizuar eshte vete vezhgues.

Te pershendesin si miq . Dhe nje miku mund t'ia qash dhe hallin, apo jo? i thua qe cdo gje shkon qetesisht . Por cdo e mire e ka nje te keqe – na ndalohet votimi. Miku degjon. Ketu miraton , ketu ngriset . Te pergezton, te pershendet dhe largohet. Ah, edhe dicka. Nuk e dija qe bexhi te shnderroka ne kameleont. Vertete e kam! Pasi mbaroj biseden me miqte e huaj , gjendem perballe nje votuesi me veshtiresi ne shikim te shoqerur nga nje familjare e tij. Kjo e fundit acarohet nga fakti qe kartat e identitetit , dikur te bujeshme , tani nuk pine me uje. " Te na e thonit me pare kete gje!- me drejtohet me vrull. – Ta dinim, nuk benim gjthe kete rruge!" Dhe drejtohet drejt daljes . Ju kujtohet kenga " E pafajshme jam". Te vjen ta shprehesh , por nuk mundesh. " Sekret profesional"i thone. Megjithate nuk u ligeshtova,jo. Djali me familjaren e tij erdhi. U be rregjistrimi i rregullt dhe gjithashtu nje votim i rregullt.

Na ishte njehere nje e diele, 12 Tetor. Na ishte nje vajze e dobet dhe e fortew e vogel dhe e madhe perballe pengesave te shumta... Nuk eshte perralle, por realitet . Qerosi mundi Katallanin. Dhe neve na duhet te mundim cdo dite shume te tille.

... Une jam " Qerosja"...Ju pershendes! Gita.

ELGITA METANI

→ projekti i FSHDP 11 perfaqesues te grupeve te ndryshme te AK. Kryetari I deges se shoqates se personave me aftesi te kufizuar te shikimit, nenkryetari I invalideve te punes, kryetari I deges se shoqates se paraplegjikeve, drejtore e Qendres se femijeve per integrim dhe zhvillim te femijeve me AK, prinder te femijeve me AK. Te gjitha me deshiren e mire per te pare sa persona me AK marrin pjese ne procesin zgjedhor, sa organet vendore, KZQV zbatojne ligjin per zgjedhjet per nje pjesemarrje te personave me AK, sa jane te pershtatura qendrat e votimit qe te gjitha te kene mundesi te barabarta per te votuar, qe te gjitha te ndjehen te barabarte para ligjit. Ne grupin e vezhguesve ishin nder me korrektet. Asnje nuk e linte karrigen bosh. Shikonin a mund te hynin te gjitha tek qendra e votimit. Fale Klubit Rotarian Christchurch ne Angli, qe solli disa rampa te levizeshme u be e mundur hyrja e personave, perdorues te karrocave e patericave me lehtesi ne qendrat e votimit. Por kish qendra si tek lokali I shkolles se mesme qe ishin shume te veshtira per tu perdorur. Aty votoi Zeqiri te cilin djemte dhe qytetare nga Librazhdi e ngriten ne krah per te votuar. Dhe jo vetem ate. Qyetaret dhane ndihmen e tyre per te gjitha personat me aftesi te kufizuar, per te qene edhe ata pjese e shoqersise se tyre. duke qene te bindur se angazhimi ne veprimtarine aktive i personave me aftesi te kufizuara i jep kuptim jetes, ndersa angazhimi politik, si pjesmarrja ne procesin e votimit i jep kuptim perfaqesimit dhe ndryshimit.

Zela Koka
kordinatore programesh
MEDPAK

Shpresa...vjen prej Hollandës

Nje projekt hollandez do te mundesoje ndertimin e nje godine te re per prodhimin e karriveve me rrota, per te cilen fondet po mblidhen nga punonjesit e kompanise Nuon, distributore e gazit dhe energjise elektrike ne Hollande, nga puna dhe pagesa qe ata marrin ne ditën e pushimit. Gjithçka ata e japin si nje ndihme per PAK ne Shqiperi.

Mijera kilometra larg, sakrifikojne parate e diteve te tyre te pushimit per te ndihmuar njerez qe nuk i kane pare kurre, me moton- "Dita ime, e ardhmja e tyre". Eshte ky programi i nje kompanie teknologjike, distributore e gazit dhe energjise elektrike holandeze qe po siguron fonde per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi. Deri me tash kane mbledhur 200 mije euro. Duan te ndertojne nje godine te re per prodhimin e karriveve me rrota per personat me aftesi te kufizuar ne vendin tone. Me qellimin, siç edhe thekson perfaqesuesi i kompanise hollandeze, Jan Bartels- " Qe te ndihmojme keta njerez dhe punishtja te kete mundesi te mbaje veten e te mos varet nga donacionet".

Pas ndertimit te kesaj godine, sipas drejtoreshes se Fondacionit te personave me aftesi te kufizuar, Blerta Cani, do te kete shume mundesi prodhimi e po ashtu punesimi per kete kategori. Godina do te ndertohet ne autostraden Tirane – Durres.

Pse vendoset te ndihmonit personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi?

" Stafit i kompanise sone i perbere nga 7 mije puntore ka vendosur te ndihmoje ne ndertimin e nje godine per prodhimin e karriveve me rrota per personat me aftesi te kufizuar.

Si sigurohen fondet?

" Punonjesit sakrifikojne ditet e tyre te pushimit. Punojne ne keto dite dhe parate e siguruara prej tyre i japin per kete projekt. Me pas vete kompania dyfishon shumen e mbledhur nga stafi".

Sa para jane mbledhur deri tani?

" Deri tani kemi mbledhur ne total 200 mije euro, por fushata do te vazhdoje sidomos per



Kristlindje, ku ne do t'u japim nje kartoline me foto te stafit te punishtes dhe me urimet shume te sinqerta te punonjesve per bashkepunimin e mbeshtetjen , gje qe mendohet se do te sherbeje per t'i sensibilizuar per te kontribuar ne vazhdimesi. Me keto para ne do te ndertojme nje godine per prodhimin e karriveve me rrota".

Cfare do te sjelle ndertimi i kesaj godine?

" Ceshtja eshte qe te krijohet nje punishte e pavaruar nga donatoret. Per kete punishtja pervec pervec mjeteve levizese duhet te punoje dhe per te tjera prodhime, te cilat duhet te shiten.

Cfare do te prodhohet tjetër?

" Ende nuk eshte vendosur por fondi i ofruar nga NUON, do te mbuloje vec te tjerash dhe permiresimin e teknologjise . Me makinerite qe do te sjellim ndoshta do te prodhohen mobileri, pajisje kuzhine apo pjese kembimi mekanike, po studjohet tregu.

Nepermjet shitjes se tyre , punishtja do te mund te zgjidhe problemet financiare, me te ardhurat

e grumbulluara do te mbulohen shpenezimet e karriveve me rrota dhe mjeteve te tjera per levizje si dhe do te sigurohet vazhdimesia e punesimit te PAK prane kesaj punishteje".

Kur do te nise ndertimi i godines?

" Ne fillim te vitit tjetër shpresoj te nise ndertimi, aktualisht eshte blere toka, po pergatitet projekti. Punimet mendojme se do te zgjasin rreth 6 muaj, dhe ne vere pritet qe punishtja "MIREZIA ", aktualisht ne ambjentet e nje ish-uzine prane " 21 Dhjetorit" te nise punen ne ambjente e reja., prane autostrades Tirane-Durres, ne kthesen e Rinasit.

" Gjithnje e me teper bizneset po marrin pamje sociale. Ne kemi patur dhe nje projekt tjetër per nje shkolle femijesh ne Rumani, si dhe projekte te tjera te vogla me perfshirjen e personelit te NUON, por ky eshte i pari ne fushen e aftesise se kufizuar. Megjithate mund t'ju them se numri i punetoreve dhe drejtuesve te perfshire ne kete nisme eshte shume me i larte se ne projektet e tjera" thote Bartels.

Aventura e Qederim Hysenit drejt Italisë
51-vjeçari me aftesi te kufizuara qe kaloi detin dy here

Në gomone me karrige me rrota

sfida
FSHDK

Eshte zvarritur per një kilometer e gjysme fill pasi ka kapercyer Otranton. Dy here ka kaluar brigjet shqiptare drejt Italisë me gomone, bashke me karrigen e tij me rrota

Qederim Hyseni eshte 51 vjec dhe prej 14 vitesh nuk ngrihet dot ne kembe. Nje aksident ne pune i ka demtuar shtyllen kurrizore. Krevati e ka mbajtur lidhur per vite me rradhe, deri ditën qe krijoi karrigen e tij te levizshme, sajuar mundimshem prej nje sedilje autobusi. “ Ndihesha si femija qe ecen per here te pare”, tregon Qederimi. Ne marsin e vitit 1997, kur vendi peshtjellohej prej trazirave, Qederimi vendosi te lere pas kater muret e shtepise , vendin e tij te lindjes, Tepelenen per te rrugetuar drejt Vlores me karrigen e tij levizese. Enderra e tij e madhe ishte Italia. Sic thote ai, atje do te niste nje tjetër jete . Ka tentuar serish , 4 vjet me vonë. Edhe nje here nje udhetim i rralle drejt Italisë , me gomone , me karrigen e tij me rrota... Sot punon vullnetar ne punishten “ Miresia” , ku prodhon karrige me rrota per te tjere.

Kur u aksidentuat?

“Jam aksidentuar 14 vjet me pare ne pune. Une punoja dispecer ne Ballsh kur u aksidentova. Qe ne ate kohe kam demtuar shtyllen kurrizore dhe nuk mund te ngrihem me kurre ne kembe”

Cfare bete pas aksidentit?

“ Menjehere pas aksidentit

gruaja me braktisi dhe mua m’u desh t’i sherbeja vetes . Kerkoja nje karrige me rrota , dhe ne pamundesi pershtata vete nje sedilje autobusi dhe me ate arrita te levizja per here te pare”.

Kur vendoset te iknit ne Itali?

“ Ne vitin 1997, gjate trazirave u nisa per ne Vlore dhe me pas nga Pashalimani jemi nisur me anije per ne Itali. Une isha me kete karrigen me rrota qe kisha adoptuar. Nuk qendrova gjate dhe u ktheva . Pastaj jam nisur edhe nje here ne vitin 2001 , kesaj rradhe me gomone. “

Si u niset me gomone?

“ Heren e pare shkova me karrigen me rrota , ndersa ne 2001 shkova me karrigen e pershtatur deri te gomonia, ndersa aty me moren ne krahe dhe me ulen. Pastaj kur mberriem ne Itali , qe kaluam detin , une kam ecur zvarre per 1 kilometer e gjysem deri sa gjeta shtepine e pare ku trokita. Atje erdhen shume media italiane , pasi ishin habitur se si nje njeri me karrige me rrota kishte kaluar detin”.

Pse doje te largoheshe nga Shqiperia?

“ Ketu beja jete azilante , te mbyllur. Doja te gjeja nje qender ku te qendroja e te ndihesha i dobishem , por nuk e dija se qendra te tilla mund te gjeja edhe ne vendin tim”.

Cfare bete ne Itali?

“ Atje me bene eksperiment



ne trupin tim. Me futen elektroda ne shtyllen kurrizore. Me sa kuptova thjesht benin eksperiment. Une i telefonova vellait dhe ai me tha te kthehesha urgjent ne Shqiperi.

Ku qendruat ne Shqiperi pasi u kthyet?

“ Shkova te nje qender ne Marikaj. Aty u ndjeva mire se na trajtonin me shume dashuri. Por nuk mund te qendroja gjate aty. Tani kam nje dhome ne Qytetin Studenti. Jetoj me pensionin e invaliditetit”.

Pse vendoset te punonit vullnetarisht te “ Miresia”?

“Une kam duar me te cilet mund te bej shume gjera. Une jam mekanik , mund te bej dicka dhe dua te integrohem. Kam tre muaj ketu, punoj sepse dua t’u sherbej bashkevuajtesve te mi. Une e di se cdo te thote per nje njeri qe nuk leviz, te kete nje karrige me rrota. Eshte si femija qe ecen per here te pare...”



Ditët e paharruara

Dy vajza nga Holanda rrefejne ditet e tyre ne Shqiperi. Dëshiren per te bere kurs praktik ne nje vend te huaj, projekt ky qe perputhej me specializimin e tyre, i cili ka te beje me kerkimin e produkteve premtuese qe nje organizate duhet te filloje te prodhoje.



“Ku po shkoni”, na pyeten kur ne u nisem per te ardhur ne Shqiperi. “Po çfare dp beni atje”, ishte pyetja tjeter qe shprehte habine e tyre. Ua treguam me pak fjale ate qe tani poi e tre-

gojme edhe ne kete shkrim:

Ne jemi dy studente nga Holanda, qe studiojme Inxhinieri Projektimi Industrial ne Universitetin Teknologjik ne Delft. Shkurt, ne mesojme sesi te kerkojme dhe te projektojme produkte te cilat do te jene opioni me I mire I radhes per t’u prodhuar nga nje kompani. Pjese e rendesishme e studimit tone eshte gjithashtu marketingu I ketij produkti te ri.

Kemi mbaruar studimet universitare ne Delft dhe tani po studiojme per master. Pjese e programit eshte internship-i (kursi praktik) ne nje kompani apo organizate per te marre nje pervoje praktike. Kur Novib, nje NGO hollandeze, (partnere me Oxfam-in) pati nje projekt per Fondacionin Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar, ne aplikuam. Te dy deshironim te benim nje internship (kurs praktik) ne nje vend te huaj dhe ky projekt perputhej shume mire me specializimin tone, I cili ka te beje me kerkimin e produkteve premtuese qe nje organizate duhet te filloje te prodhoje. Dhe duke pare atlasin, na zuri syri nje vend te vogel me male, liqene dhe plazhe dhe menduam: Kete vend ia vlen ta vizitosh!

Ne kete moment, projekti yne ka perfunduar: ne kemi projektuar nje produkt qe pun-

ishte Miresia duhet te prodhoje dhe shesi me qellim qe te nxjerri fitime. Me keto fitime mund te prodhohen dhe shperndahen me shume karrike me rrota per personat me aftesi te kufizuar! Pra çfare kemi bere gjate tre muajve te fundit?

Sic ndodh ne projekte te tilla, ne filluam me analizen e situates per te krijuar nje ide te plote te saj. Kete here gjithsesi ishte e vecante per ne, sepse ne dinim shume pak per FSH-DPAK dhe Miresine dhe absolutisht asgje per Shqiperine ... Me analizen qe I beme Miresise, ne pame se ne te ka shume njohuri dhe pervoje lidhur me perpunimin e tubave te metalit ne punishte.

Pastaj filluam te shihnim tregun; per cilin sektor do te ishte me premtuese qe te prodhoje produkte tubi metalit? Pame se sektori I zbatimjes po rritet me shpejtesi ne Shqiperi. Krahasuar me Hollanden dhe vende te tjera, ende nuk ka shume mundesi per zbatimje ne Shqiperi. Per shembull nuk ka shtigje te hapura ne male per ecje/marshime apo shetitje diteve te djela, ka vetem nje kopsht zo-ologjik shume te vogel, nuk ka parqe me teme familjare (si Disney World), nuk ka pishina ne ambiente te brendshme te mbuluara ku femijet te mund te luajne, nuk ka fusha golfi, etj. Megjithate



në misionin shqiptar

gjerat po ndryshojne shpejt; gjithnje e me shume bare po hapen cdo dite dhe tani salla e pare per bowling ne Shqiperi ka hapur dyert ne Durres!

Duke shkuar nga nje bar ne nje tjetër për një ditë të tere dhe duke folur me pronaret e tyre, ne pame që mobilimet metalike për bare dhe terraca do të ishin një produkt premtues për Miresine. Baret kanë nevojë për një numër të madh produkte – rreth 10 tavolina dhe 40 karrike – dhe mobilim i ri nevojitet mjaft shpesh – rreth një herë në katër vjet – pasi bareve shpesh iu ndryshojnë pronaret, kështu që kjo do të bente që një produkt i mirë të shitej shumë me një fitim të lartë. Pas një procesi të gjere projektimi, projekti final është ai që tregohet në figure. Ne e quajmë atë “James”, pasi është një tavoline dhe karrike clodhese. Është një karrike nga e cila – ndërsa je ulur në të – ju mund të porosisni një Martini me akull ‘shaken, not stirred’, tamam si vete James Bondi! Është bere me tuba metal, pllaka druri për tavolinën dhe cope tekstili për karriken. Për të plotësuar dëshirat e klienteve janë të mundur disa variacione: tipe të ndryshme druri apo tekstili, forma të ndryshme të drurit, mund të shihet një xham për tavolinën, dhe natyrisht ka ngjyra të ndry-

...ana pozitive është se ne mund t’iu themi miqve tanë se Shqipëria është një vend i bukur që ia vlen t’a vizitosh.

shme. Kështu po e shfrytëzojmë rastin për të bërë pak promovim: nëse ju apo ndonjë i afërm i juaj është i interesuar për këto mobilje të bukur, telefononi FSHDDPAK ose Miresinë! Për cdo shitje, me shumë femijeve iu sigurohet një jetë me e mirë duke i paisur me karrike me rrota!

Përveç punës për projektin që e bëmë me gjithë zëmër, ne gjithashtu shfrytëzojmë rastin për të parë Shqipërinë me nga afër. Vizituam Durresin, Krujen, Fierin, Vloren, Himaren, Saranden, Gjirokastrën, Elbasanin, Beratën dhe Pogradecin. Na pelqyen ndertesat e bukura të stilit turk dhe qendrat e vjetra të qyteteve; vecanerisht kalatë e Gjirokastrës dhe Beratit ishin vertete shumë të bukura! Gjithashtu na pelqeu shumë natyra. Sic mund ta dini, Holanda është e sheshtë, kështu që ne jemi shumë të kenaqur me malet e bukura që janë këtu! Por dhe vija bregdetare në Himarë dhe bregu i Liqenit të Ohrit ishin shumë të bukur. Një tjetër aspekt me interes për

ne ishin ndertesat e vjetra dhe rrenojat, si në Butrint dhe në Apolloni. Është integruese të dish se shumë vite më parë, kishte njëzëz që jetonin në këto vende, ndërsa në Holandë nuk kishin shtëpi prej guri fare.

Për më tepër, ne kaluam disa ditë si vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e fundit lokale. Është interesante të shihje se në format tona të vëzhgimit, kishte dhe pyetje lidhur me pershtatshmerinë e ndertesave për personat me aftësi të kufizuara. Në na vjen keq të themi se pothuajse në të gjitha qendrat e votimit mund të hyjë vetëm me anë të shkalleve apo pengesave të tjera ...

Tani po përgatitemi për t’u kthyer në shtëpi dhe na duhet t’i themi mireupafshim këtij vendi të bukur. Por ana pozitive është se ne mund t’iu themi miqve tanë se Shqipëria është një vend i bukur që ia vlen t’a vizitosh.

Mirupafshim,
**MAAIKE DE BOER &
MAAIKE BEEREPOOT**

Vijon nga numri i kaluar

1889

Shoqata Kombetare e personave qe nuk degjojne vendos memorialin e Tomas Gallaudet ne Kolegjin Kombetar te personave qe nuk degjojne e nuk flasin (tani Universiteti Gallaudet).

1894

Kolegji Kombetar i personave qe nuk degjojne e qe nuk flasin kthehet ne Kolegjin Gallaudet.

Viti 1900 ES – deri tani

1916

Braille anglez u be gjuhe standarte ne Angli

1921

Krijohet Fondacioni Amerikan per te Verberit, nje shoqata jofitimprures, e njohur si reagim ndaj rastit te Hellen Keller ne Amerike.

1935

Ne New York City krijohet Liga e Personave me Aftesi te Kufizuara Fizike, per te protestuar ndaj diskriminimit qe u behej nga Administrata qe siguronte pune (WPA)(zyra e punes). Kjo lige me rreth 300 njerez – shumica me aftesi te kufizuar, polio dhe paralize cerebrale – te gjithëve iu eshte mohuar e drejta per pune. Zyra e strehimit te New York-ut duhej qe te gjitha kerkesat per pune t’ja kalonte zyres se punes , por nderkohe nuk e kishte bere kete per personat me aftesi te kufizuara fizike, si sinjal qe zyrat e punes te mos iu jepte pune ketyre njerezve. Perfaqses te liges qendruan ne Zyrat e strehimit per 9 dite; dhe shkuan ne Zyrat e punes dhe qendruan ulur gjate gjithë fundjaves. Si pasoje e gjithë kesaj, mijera vende pune u hapen ne te gjithë vendin.

Ne Amerike, Dr. Alexis Carrel, fitues i cmimit Nobel, staf i Institutit te Rokfelerit qysh me krijimin e tij boton librin “ Njeriu – i Panjohuri “ Aty ai sygjeron zhdukjen e personave me probleme mendore dhe krimineleve, ne institute te pajisur me Gazin e nevojshem per ta realizuar kete.

1939

Me shperthimin e Luftes se Dyte Boterore, Hitleri urdheron “ vrasjen ne mase per meshire” te te semureve dhe personave me aftesi te kufizuar. Programi

nazist ishte kodifikuar si Aktion T4 dhe ishte institucionalizuar te eleminonte “ jetet qe nuk ja vlente te jetoreshin”.

1941

Ne 3 Gusht 1941 ne Gjermanine naziste, nje bishop katolik, Clemens von Galen jep nje meshe ne katedralen Munster, duke sulmuar programin nazist e duke e quajtur ate “ thjesht vrasje”.

(23 Gusht 1941) Hitler e nderpret AktionT4, i cili nderkohe kishte arritur te shkaktonte 100.000 vdekje. Megjithate programi nazist vazhdonte, duke perdorur ilacet dhe vuajtje te tjera ne vend te gazit.

1953

Ed Robert, (i prekur nga polio), fillon levizjen “ Per jetese te pavarur “.

1971

Ed Roberts dhe shoket e tij, formojne nje Qender per Jetese te Pavarur (CIL) ne Berkeley, per komunitetin. Fillimisht qendra ishte ne nje apartament me 2 dhoma gjumi, derisa u siguroa nje fond prej 50.000 \$ ne 1972

1974

Formohet koalicioni i Grave me Aftesi te kufizuara

1983

Fillon veprimi per transport te pershtatur per PAK nga ADAPT

1990

(26 Korrik 1990) ceremonia per nenshkrimin e Ligjit Amerikanet me Aftesi te Kufizuara(ADA) ne Shtepine e Bardhe. Sekretari i Transporteve, Sam Skinner, me ne fund nxjerr rregulla per autobuza te pershtatur.

1995

Lufta per te drejtat e Personave me aftesi te kufizuara ne Afriken e Jugut shenon nje hap perpara zgjedhjeve ne Parlament, per here te pare ne histori dy gra, drejtuese me aftesi te kufizuara ne Afriken e Jugut dhe Zimbabve. Zgjedhja e Maria Rantho ne 1995 ne Qeverine e Nelson Mandeles ne Afriken e Jugut dhe Ronah Moyo ne Prill ne qeverine e Robert Mugabe ne Zimbabve, shenon fillimin e nje epoke ne historine e njerezve me aftesi te kufizuara.